



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-12830/24 datë:22.05.2024



Npi – 01/177 datë: 29.05.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) neni 17 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Neni 4 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4.3.1 të Ligjit Nr.03-L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010; Kuvendi i Komunës duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastrë dhe Gjeodezi, Nr.02/454 të datës 22.05.2024, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa Npi-01/171 të datës 27.05.2024, në seancën e mbajtur më 29.05.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM NGASTRËN KADASTRALE
Nr.1893-0, Z.K-SHTIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 29.05.2024, unanimisht miratoi, vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-01893-0; Zona Kadastrale – Shtime; Shfrytëzimi aktual i parcelës Oborr – Shtëpi; Evidentuar në emër – Fadil (Shefki) Nuha; Me sipërfaqe totale 324 m².

II

A r s y e t i m: Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm të kësaj Ngastre Kadastrale sipas dispozitivit të këtij vendimi është si vijon: Zgjerimi – Zyrtarizimi i rrugës “Mic Sokoli” si dhe ndërtimi i Rrethrrrotullimit, i cili i lidhë rrugët “Komandant Kumanova” me rrugën “Skender Salihaj” dhe rrugën “Mic Sokoli” në Shtime.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi e Kuvendit

Adnan Ademi